REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:009901

Datë: 04.05.2022

Numri i dokumentit: 02976841

PML.nr.110/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar kolegji, Valdete Daka dhe Agim Maliqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të dënuarit R.P., për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.168/2021 të datës 22.4.2021 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.883/21 datë 13.12.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më 26 prill 2022, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit, R.P., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm P.nr.168/2021 të datës 22.4.2021 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.883/21 datë 13.12.2021.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr. 168/2021 të datës 22.4.2021, e ka shpallur fajtor të dënuarin R.P. për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 2(dy) viteve dhe me dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro, të cilën shumë i dënuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej

2022:050636

15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Nëse i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata mund t ia zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burg, ashtu që 20 euro gjobë llogaritet barazi me një ditë burgim, respektivisht 25 ditë burgim ndërsa e dëmtuara Albanita Zeqiri, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil, gjithashtu gjykata e obligon të dënuarin që kësaj gjykate t'ia paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë për paushallin gjyqësor shumën prej 20 euro dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA.1.nr.883/21 e datës 13.12.2021 ka aprovuar si të bazuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit R.P., dhe ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë vetëm sa i përket vendimit mbi të dënimin, ashtu që për veprën për të cilën është shpallur fajtor të dënuarit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë), të cilin dënim do ta vuaj në afat prej 15 ditë pasi që aktgjykimi ta merr formën e prerë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të dënuarit R.P., av. Reshat Millaku, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar këtë kërkesë dhe aktgjykimet e lartpërmendura t'i anulojë dhe çështjen penale ta kthej tek gjykata e shkallës së parë në rigjykim, ose ti ndryshoj në atë mënyrë që të bëj rikualifikimin e juridik të veprës penale, ne vepër penale të vjedhjes nga neni 313 par.1 të KPRK - së, dhe ta gjykoj me dënim me kusht ose ti shqiptoj dënim më të butë, ose në rastin ma të pavolitshëm ti shqiptoj minimumin e dënimit sipas nenit 77 par.1 nënpar.1.3 të KPRK –së.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr.64/22 e datës 28.3.2022, ka propozuar që kërkesa e mbrojtësit të të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 të KPPK-së dhe, pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë pretendon se aktgjykimet e atakuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.8,1.12 par.2 nënpar.2.1 dhe 2.2 të kodit të procedurës penale, duke theksuar se aktgjykimet bazohen në prova të papranueshme, sepse CD- ja në parkingun e qendrës tregtare "INEREX", është mare si provë në kundërshtim me dispozitat e KPP-së, për arsye se CD-ja është dashur të merret me vërtetim për sekuestrimin e përkohshëm nga policia e Kosovës. Mbrojtësi po ashtu pretendon se me aktgjykimet e atakuara është shkelur ligji penal në dëm të të dënuarit, e këtë duke theksuar se nuk kemi të bëjmë me vepër penale të vjedhjes së rëndë, por vetëm vjedhje nga neni 313 të KPRK –së, gjithashtu në fund ka theksuar se aktgjykimet e lartcekura

2022:050636

janë të kundërligjshme edhe sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, dukë e marr parasysh dëmin që i është shkaktuar të dëmtuarës nga vjedhja është në shumë prej 510 eurosh.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të pabazuara, ngase aktgjykimet e kundërshtuara janë konkrete, të kuptueshme dhe të bazuara në ligj, dispozitivi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me arsyetimin dhe se përmban arsye të duhura mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje penale. Gjithashtu Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë ka dhënë përgjigje të qarta dhe të plota për secilin pretendim të mbrojtësit të të gjykuarit ,e që të njëjtat pretendime mbrojtësi i ka përsëritur edhe në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, e të cilat arsyetime i mbështet edhe kjo gjykatë.

Nga shkresat e lëndës del se pas ngritjes së akuzës ndaj tani të dënuarit R.P. për veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 të KPRK-së, gjykata e shkallës se parë e ka mbajt seancën e shqyrtimit fillestar me datë 22.4.2021, gjyqtari i çështjes konform dispozitës së nenit 246 par.1 të KPP e ka njoftuar tani të dënuarin për të drejtën e tij të kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmerinë e provave të paraqitura në akuzë. I dënuari në prani të mbrojtësit të tij është deklaruar se i kupton të drejtat e tij procedurale. Pasi që Prokurori ka deklaruar se i ka përmbushur detyrimet e veta konform dispozitës së nenit 244 te KPP dhe në ketë drejtim i dënuari s'ka bërë vërejtje, është ftuar Prokurori që ta lexojë akuzën dhe i dënuari R. është deklaruar se e ka kuptuar akuzën. Pasi që gjyqtari i çështjes është bindur se i dënuari e ka kuptuar akuzën ia ka ofruar mundësinë që ta pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm dhe i dënuari në prani të mbrojtësit Nazmi Mustafi ka deklaruar se *"e ndien veten fajtor në tërësi për veprën penale për të cilën akuzohet, pranimin e fajësisë e bën në mënyrë vullnetare dhe pa imponime, shpreh keqardhje për rastin dhe i premton gjykatës së nuk do të përsërisë veprime të tilla"*. Prokurori është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e tani të dënuarit kurse edhe gjykata pasi qe ka vlerësuar se kërkesat nga neni 248 te KPP janë përmbushur e ka aprovuar pranimin e fajësisë me aktvendim dhe nuk ka administruar prova ne ketë çështje por ka vazhduar me fjalën përfundimtare dhe e ka shpall fajtor dhe dënuar.

Meqë i dënuari e ka pranuar fajësinë, pretendimet sa përket provave nuk janë të bazuara, ngase në shqyrtim fillestar fare nuk janë administruar prova dhe gjykata nuk i ka vlerësuar të njëjtat dhe nuk ka mundur të jep arsyetim lidhur me prova në aktgjykim.

Gjithashtu , sipas vlerësimit të kësaj gjykate edhe ligji penal është aplikuar drejt, kur në veprimet e të dënuarit është konstatuar se qëndrojnë elementet e veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 të KPPK-së, kjo ngase qëndron fakti se i dënuari nuk e ka kryer veprën penale duke e thyer veturën dhe duke depërtuar në të me forcë, mirëpo i njëjti e ka kopjuar çelësin origjinal nga e dëmtuara e cila e ka mbyllur veturën nga distanca. Pra, kjo gjykatë gjen se edhe kopjimi mi çelësit në mënyrë elektronike (me përdorim të teknologjisë) është në funksion të tejkalimit të pengesave e me qëllim të në atë mënyrë të arrihet deri te pasuria e huaj e luajtshme. Element qenësor i veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 të KPPK-së

2022:050636

është "heqja e pengesave me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme" dhe në rastin konkret i dënuari ka tejkaluar pengesat duke e kopjuar çelësin origjinal dhe duke e përdor te njëjtin për të hapur veturën e pastaj ka përvetësuar pasurinë e luajtshme. Sipas vlerësimit të kësaj gjykata ,drejtë kanë vepruar të dy gjykatat ,kur kanë gjetur se në veprimet e të dënuarit formohen elementet qenësore të veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së për të cilën është shpallur fajtor dhe dënuar dhe drejtë është aplikuar ligji penal, prandaj edhe pretendimi i mbrojtësit në këtë drejtim del i pabazuar.

Andaj, nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale ,as të ligjit penal në dëm të të dënuarit dhe nga sa u parashtrua më lartë, e në kuptim të nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.110/2022, më 26 prill 2022.

Procesmbajtësja,
Minire Xhambazi

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta

2022:050636